



SA ËSHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të
sektorit publik në RM

PROJEKT: NDJEKJA E DREJTËSISË ADMINISTRATIVE



**SA ËSHTË I MADH DHE ÇFARË
SEKTORI PUBLIK KEMI NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?**

Analizë e karakteristikave të
sektorit publik në RM

Qendra e Menaxhimit me Ndryshime (QMN)

janar, 2017

SA ŅSHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

ANALİZË E KARAKTERISTIKAVE TË SEKTORIT PUBLIK NË RM

Botues: Qendra për menaxhim me ndryshime

Për botuesin: Neda Maleska Saçmaroska, Qendra për menaxhim me ndryshime

Autorë: Dragan Gocevski, Neda Maleska Saçmaroska

Redaktorë: Gordana Stefkovska – Veljanovska

Përkthimi dhe lektura: AD Verbum

Dizajn dhe shtyp: Brigada dizajn

Tirazhi: 200 kopje (Falas/Tirazh jokomercial)

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

35.071/.088(497.7)

GOCESKI, Dragan

Sa ñshtë i madh dhe çfarë sektori publik kemi në Republikën e Maqedonisë (RM)? : analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM / [Dragan Goceski, Neda Maleska-Saçmaroska]. -

Skopje : Centar za upravuvanje so promeni, 2017. - 40 стр. : илустр. ; 24 см

Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамките на проектот:

“Monitorim i Drejtësisë Administrative”

ISBN 978-608-4818-12-0

1. Maleska-Saçmaroska, Neda [автор]

а) Јавна администрација - Структура - Македонија COBISS.MK-ID 103030026



British Embassy
Skopje

Ambasada Britanike Shkup mbështeti përgatitjen e këtij materijali, brenda projektit “Monitorim i Drejtësisë Administrative”.

Përbajtja e këtij materijali nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike.

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	3
Rezyme	5
NOCIONET THEMELORE	7
Për çfarë flasim kur themi administratë publike?	7
Cili është roli i administratës publike në shtet?	7
Çka do të thotë fushë veprimi i administratës publike?	8
Kush punon në administratën publike?	9
Cili është vëllimi i sektorit publik	10
KARAKTERISTIKAT E SEKTORIT PUBLIK NË MAQEDONI.....	14
Sa të punësuar ka në sektorin publik në Republikën e Maqedonisë?	14
Ku në sektorin publik ka më shumë të punësuar?	16
Çfarë është struktura gjinore e sektorit publik? Bota mashkullore apo femërore? ..	20
Struktura gjinore dhe etnike e administratës shtetërore në Maqedoni	23
Çka do të thotë numri i të punësuarve në sektorin publik?	25
Sa fitohet në sektorin publik?	32
Sa na kushton sektori publik?	34
Çfarë janë perceptimet për cilësinë e punës së administratës në lidhje me rajonin?	37



REZYME

M

adhësia dhe fushë veprimi i sektorit publik në një vend nuk mund të përkufizohet vetëm përmes pyetjes "Sa njerëz punojnë në sektorin publik?". As nuk është e rëndomtë të jepet përgjigje në pyetjen se sa njerëz duhet të punojnë apo sa të punësuar është "normale" të ketë në sektorin publik. Në këtë analizë do të japim interpretimin e disa karakteristikave të sektorit publik të shqyrtuara nga më tepër aspekte me të cilat do t'u japim përgjigje pikërisht këtyre pyetjeve: Sa i madh duhet të jetë sektori publik, a është i shtrenjtë, nëse dhe sa është cilësor edhe sektori publik në Maqedoni, e bën vend evropian apo jo.

Në vendet e zhvilluara, qytetarët presin më tepër shërbime të shtetit, prej qasjes deri në ujin e pijshëm dhe energjinë, mirëmbajtjen e rrugëve, deri në arsimin cilësor, shëndetësinë, sigurinë dhe të drejtën e privatësisë. Sa më tepër shërbime presim, aq më tepër njerëz janë të nevojshëm në sektorin publik që t'i administrojnë këto servise. Fushë veprimi i sektorit publik nuk varet drejtpërdrejtë nga madhësia e popullsisë. Pyetja se sa të punësuar në sektorin publik duhet të kemi më shpesh varet prej asaj se sa njerëz marrin rroga nga paratë publike që një shtet mund të qëndrojë. Si rrjedhojë, vendet e vogla kanë sfidë të madhe me mbajtjen e sektorit publik nga shtetet e mëdha për çka mund të janë kreativë në zgjidhjet sistematike dhe të kenë kujdes se sa njerëz punojnë në sektorin publik.

5

Në këtë hulumtim, krahas numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin publik në Maqedoni, jemi shërbyer edhe me indikatorë tjerë për madhësinë e përgjithshme të sektorit publik: trendi i përgjithshëm i punësimeve në sektorin publik në një periudhë të caktuar të kohës, struktura e tij sipas veprimitarive, struktura gjinore, rrogat në sektorin publik, pjesëmarrja e sektorit publik në lidhje me popullsinë e përgjithshme të shtetit, si dhe pjesëmarrja e administratave komunale në lidhje me popullsinë e rajoneve planore dhe pjesëmarrja e shpenzimit të përgjithshëm të qeverisë në bruto prodhimin vendor. Parametrat e shfrytëzuara janë krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Evropës me qëllim të vendoset trendi i përgjithshëm i Maqedonisë në lidhje me vendet tjera.

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ŘSHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

Në lidhje me indikatorët e shfrytëzuar, sektori publik në Maqedoni nuk dallohet shumë nga vendet tjera në Ballkanin Perëndimor në lidhje me numrin e përgjithshëm të të punësuarve. Edhe pse, në dallim nga shumica e vendeve në Evropë në të cilat prej vitit 2008 deri në vitin 2009 u shënua trendi i rënies së numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Maqedoni ka rritje konstante.

Sipas strukturës dhe veprimitarive, rritja më e madhe e punësimeve u shënua në administratën publike, mbrojtjen dhe veprimitaritë nga sfera e sigurimit të detyrueshëm social, kurse prej vitit 2012 deri në vitin 2013 në arsim dhe shëndetësi u shënua një rënie dhe stagnim i lehtë i numrit të të punësuarve.

Rrogat në administratën shtetërore në mesatare janë më të larta se rrogat në veprimitaritë tjera të sektorit publik, por këto dallime nuk janë të mëdha. Në lidhje me sektorin publik, rrogat në administratën shtetërore janë më të ulëta se rrogat në sektorin e TI-së, shërbimet financiare dhe sektorin energetik, por janë më të larta në bujqësi, industrinë e përpunimit dhe shërbimet e hotelorisë. Në lidhje me madhësinë e popullsisë, sektori publik në Maqedoni paraqet diçka më tepër se 6% të numrit të përgjithshëm të banorëve dhe diçka më tepër se 18% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve, me çka Maqedonia ka sektor publik më të vogël se vendet më të zhvilluara në Evropë, e nuk dallohet shumë nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

6

Në sektorin publik në Maqedoni, femrat janë të përfaqësuara në mënyrë përkatëse dhe se shteti nuk dallohet shumë nga mesatarja evropiane. Ky është një trend i vërejtur në të gjitha vendet në Evropë, përveç në Turqi.

Në nivel të rajoneve planore, numri i të punësuarve në administratat komunale në tërësi paraqet një pjesë të vogël të tërë popullsisë (më të vogël se 0.006%). Vërehet se rajonet me popullsi të madhe në parim kanë administrata më të mëdha komunale të shprehur në numrin e përgjithshëm të të punësuarve. Nga ana tjetër, rajonet me BPV më të madhe për kokë banori dhe shkallë më të lartë të punësimit kanë administrata më të vogla komunale nga rajonet me shkallë më të ulët të BPV-së për kokë banori dhe shkallë më të ulët të punësimit. Me fjalë tjera, rajonet me më shumë të papunësuar kanë administrata më të mëdha komunale.

NOCIONET THEMELORE

PËR ÇFARË FLASIM KUR THEMI ADMINISTRATË PUBLIKE?

Edhe pse nuk ekziston përkufizim konciz për administratën publike ekziston një pëlqim i gjerë ndërmjet bashkësë shkencore, me këtë nociion të nënkuptohen të gjitha institucionet publike që janë drejtpërdrejtë të përfshira në zbatimin e ligjeve të një shteti. Në shtetet e zhvilluara demokratike, këto institucione si servis i qytetarëve në realizimin e të gjitha të drejtave u garantohen me ligj.

L.D. Vajt „Administratën publike e përbëjnë të gjitha operacionet që kanë për qëllim realizimin dhe zbatimin e politikave publike“.

Vudrou Vilson „Administrata publike paraqet zbatimin sistematik dhe të hollësishëm të ligjeve“; „çdoherë kur rregulli i përgjithshëm si ligji, zbatohet në një situatë konkrete, bëhet fjalë për një akt (vepër) të administratës“.

7

Luter Gulik „Administrata publike është pjesë e shkencës së administratës e cila merret me punët e qeverisë (pushtetit ekzekutiv) dhe para se gjithash, merret me zbatimin e politikave të pushtetit ekzekutiv“.

Dvajt Valdo „Administrata publike është art dhe shkencë për menaxhim me punët shtetërore“.

CILI ӮSHTË ROLI I ADMINISTRATËS PUBLIKE NË SHTET?

Për shkak të rolit të drejtpërdrejtë në zbatimin e ligjeve shpeshherë duke menduar në administratën, ajo përzihet me pushtetin shtetëror dhe pushtetin lokal. Edhe pse këto institucione janë pjesë e pushtetit ekzekutiv (para se gjithash) këto nuk janë dhe nuk duhet të janë politike. Kuvendi, Qeveria dhe Gjykatat, si dhe komunat janë bartës të pushteteve. Deputetët, anëtarët e qeverisë, kryetarët e komunave dhe këshilltarët në komuna sipas përkufizimit janë politikanë. Administrata publike nuk miraton ligje. Ajo merr pjesë në përgatitjen e tyre, kryen analiza profesionale të gjendjeve të ndryshme në shoqëri, i ndjek gjendjet dhe jep iniciativa për miratimin e politikave publike dhe zgjidhjeve të reja ligjore dhe këtu paraqitet vetëm si servis profesional i pushteteve shtetërore dhe lokale.

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ŠEHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

ÇKA DO TË THOTË FUSHË VEPRIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE?



Fushë veprimi i administratës publike drejtpërdrejtë del nga lloji i sistemit politik dhe roli i shtetit në shoqëri. Sa më tepër pritet nga shteti aq fushë veprim më të madh do të ketë edhe administrata publike. Në të kaluarën e largët shteti është marrë kryesish me siguri të brendshme dhe të jashtme, grumbullimin e të dhënavë dhe tregtinë, dhe si rrjedhojë edhe numri i institucioneve dhe të punësuarve të nevojshëm për shërbimin e shtetit ka qenë më i vogël. Pas revolucionit industrial dhe me zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, dukuria e liberalizimit si ideologji dominuese në botën moderne, prej shtetit pritet të sigurojë kushte për një jetë të rehatshme, prosperitet ekonomik dhe të drejta të tjera të shumta për qytetarët e vet, siç janë: arsimi, shëndetësia, qasja në energjensë, uji i pijshëm, rrugët moderne, mjedisi i shëndoshë jetësor, telekomunikimet, etj. Me rritjen e rolit të shtetit modern në jetën e përditshme të qytetarëve ashtu është rritur edhe fushë veprimi i administratës publike, si përbledhje e institucioneve që i zbatojnë politikat publike të qeverisë dhe përmes së cilave qytetarët i realizojnë të drejtat e tyre.

8

Në varësi nga ajo nëse administrata publike paraqitet si servis i pushteteve shtetërore apo është servis i opinionit, shtetet i shqyrtojmë si nga aspekti autoritar apo nga aspekti demokratik.

Në kuptimin e gjërë, me administratë publike në teori konsiderohet administrata shtetërore (ministratë, organet në përbërje të ministrike, siç janë: inspektoratet, drejtoritë dhe byrotë, organet e pavarura të shtetit siç janë: agjencitë dhe drejtoritë e shumta), shërbimet profesionale të qeverisë, kuvendi dhe gjykatat, organizatat administrative (siç janë: Enti Shtetëror i Statistikës, Arkivi Shtetëror), vetëqeverisja lokale, institucionet dhe ndërmarrjet publike. Në kohën më të re, me administratë publike konsiderohen edhe organizatat e sektorit publik të cilat me leje nga shteti japin shërbime publike: shoqëritë tregtare me autorizime publike siç janë: Telekomi i Maqedonisë, one.Vip, EVN, klinikat shëndetësore private, universitetet private, etj., si dhe shoqatat si: Unioni i Shoferëve, Lidhja Automoto e Maqedonisë, etj., Këto organizata, sipas rregullit, nuk konsiderohen sektor publik.

KUSH PUNON NË ADMINISTRATËN PUBLIKE?

Administrata publike në kuptimin bashkëkohor të fjalës është i përbërë prej profesionistëve, personave që punësohen nga karriera dhe punën e tyre e ushtrojnë si profesion profesional dhe të karrierës, kurse për kompensim marrin rrögë. Sipas rregullit, të punësuarit në administratën publike që janë drejtpërdrejtë të ngarkuar me ushtrimin e funksioneve publike, përkatësisht dhënien e drejtpërdrejtë të shërbimeve për qytetarët dhe bashkësinë e biznesit kanë një status të veçantë që i dallon nga të punësuarit në sektorin privat. Ky status është i rregulluar me ligj. Prej shtetit në shtet shënohen dallime në statusin juridik të kësaj kategorie të të punësuarve, por më shpesh quhen nëpunës publikë, nëpunës shtetërorë, nëpunës administrativë, etj. Në Republikën e Maqedonisë prej vitit 2014, të punësuarit në administratën publike quhen nëpunës administrativë.

Nëpunësit administrativë janë të punësuar në administratën shtetërore dhe publike (klasike) që kryejnë punë administrative: punë profesionale administrative, punë normative juridike, punë ekzekutive, punë statistikore, punë administrative mbikëqyrëse, punë planore, punë informatike, punë kadrorike, punë materiale, punë financiare, punë të kontabilitetit, punë informative dhe punë tjera me natyrë administrative. Me fjalë tjera, këta të punësuar zgjidhin lëndë sipas kërkesës së qytetarëve dhe personave juridikë kur realizojnë të drejtat e tyre apo zbatojnë obligime ligjore ndaj shtetit, zbatojnë mbikëqyrje (të inspeksionit, profesionale etj.), kryejnë analiza profesionale, përgatisin rregulla për nevojat e organeve të pushtetit shtetëror, etj.

Nëpunësit shtetërorë (sipas rregullit) janë të punësuar në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal dhe organet tjera shtetërore: ministritë, organet në përbërje të ministrive, si inspektoratet, byrotë, drejtoritë, etj., në shërbimet profesionale të Qeverisë, Kuvendit, presidentit të shtetit, Avokatit të Popullit; organizatat administrative si Enti Shtetëror i Statistikës dhe Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë; dhe shërbimet profesionale të njësive të vetëqeverisjes lokale.


Nëpunësit publikë janë nëpunës administrativë të punësuar në institucionet që ushtrojnë veprimitari nga sfera e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, sportit, si dhe në veprimtaritë tjera me interes publik të përcaktuar me ligj, kurse të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë apo nga komunat, nga Qyteti i Shkupit, si dhe nga komunat në Qytetin e Shkupit.

CILI ŪSHTË VËLLIMI I SEKTORIT PUBLIK

Me rëndësi është ta kuptojmë dallimin ndërmjet administratës publike dhe sektorit publik. Sektori publik e paraqet administratën publike të kuptuar në kuptimin e saj të gjërë, përkatësisht i përfshinë të gjitha institucionet publike që ushtrojnë funksione dhe veprimtari publike, por që janë të themeluara nga shteti apo komunat dhe financohen, sipas rregullit, nga mjetet publike, përkatësisht buxheti i shtetit apo buxheti i komunave. Kjo do të thotë, se me sektor publik konsiderohen vetëm institucionet publike, duke i përfshirë edhe shërbimet profesionale të Qeverisë, Kuvendit dhe organeve të jurisprudencës, dhe se nuk konsiderohen institucionet private (spitalet private, shkollat private, foshnjoret private etj.) dhe kompanitë private që japid shërbime publike.

Për rregullimin e statusit juridik të afér 128,347¹ personave të punësuar në sektorin publik më 5.2.2014, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për të punësuarit në sektorin publik² dhe Ligjin për nepunësit administrative³, të cilat hynë në fuqi më 13.2.2014 me zbatim të anuluar prej një viti, përkatësisht fillojnë të zbatohen prej 13.2.2015.

Në pajtim me të dhënat e Regjistrit të të punësuarve në sektorin publik prej marsit të vitit 2016, janë përfshirë gjithsej 1287 institucione publike që e përbëjnë sektorin publik në Republikën e Maqedonisë.⁴



¹ Regjistri i të punësuarve në sektorin publik, MSHIA, 2016, fq. 4;

² I miratuar më 5.2.2014, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 27/2014;

³ Ibid;

⁴ Regjistri i të punësuarve në sektorin publik, Ibid, fq. 13;

Diagrami 1: Sektori publik në Republikën e Maqedonisë

Administrata publike	Administrata shtetërore:	32 organe të pavarura të administratës shtetërore 29 organe në përbërje të ministritve 16 persona juridikë me autorizime publike 15 ministri 12 organe të pavarura shtetërore 10 trupa rregullatorë 3 sekretariate në Qeveri 1 organ i veçantë i administratës shtetërore (zbulimi) 1 shërbim në Qeveri		
	81 komuna	Shërbime publike:	888 institucion publike	128 ndërmarrje publike
Jurisprudencia	35 gjykata	29 institucion publike	Këshilli Gjyqësor	Këshilli i Prokurorëve Publikë
Pushteti shtetëror	Kuvendi i RM-së	Qeveria e RM-së	Presidenti i RM-së	11
Të tjera	Banka Popullore e RM-së	Avokati i Popullit		

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ŠESTHË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

Diagrami 2: Korniza juridike e sektorit publik në Republikën e Maqedonisë

Ligji për të punësuarit në sektorin publik është ligj ombrellë i cili e cakton kornizën juridike dhe i parashikon të gjitha llojet e të punësuarve në sektorin publik. Vendet e shumta dhe të ndryshme të punës janë ndarë në 4 grupe.

Secili grup përfshinë veprimtari të ndryshme publike.

Edhe pse të gjithë janë të punësuar në sektorin publik, me rëndësi të dihet është se bëhet fjalë për profesione të shumta të cilat dallohen njëri prej tjetrit.

Nuk ka rregull të vetme që i rregullon rrogat në sektorin publik.

E as rregull që e cakton numrin maksimal të të punësuarve.

Grupi 1. Nëpunësit administrativë (nëpunës shtetërorë dhe publikë)

Lex specialis është Ligji për nëpunësit administrativë

Grupi 2. Personat zyrtarë janë me autorizime të vecanta / siguri, mbrojtje, zbulim.

Këtu përfshihet policia, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, armata e Republikës së Maqedonisë, etj.

Lex specialis janë Ligji për polici, Ligji për shërbim ushtarak, etj.

Grupi 3. Dhënësit e shërbimeve publike (shëndetësi: mjekët, motrat medicinale), arsim (mësimdhënësit në arsimin fillor dhe të mesëm, profesorët universitarë), shkencë (hulumtuesit në institutet shkencore), punë (Agjencja e Punësimit e RM-së), punët sociale, mbrojtja e fëmijëve (punëtorët socialë), kulturë (arkeologë, përgjegjës në muzetë dhe galeritë, konservatorë, etj.), informim publik (Radiotelevizioni i Maqedonisë, etj.), veprimtaritë komunale dhe ndërmarrjet tjera publike (shoferët në komunikacionin publik, të punësuarit në ujësjellës, etj.)

Lex specialis (Ligji për arsim dhe shkencë, Ligji për mbrojtje shëndetësore, Ligji për ndërmarrje publike...)

Grupi 4.
Ndihmës personi teknik

Ligji për marrëdhënie pune dhe Marrëveshjet kolektive zbatohen për të gjithë të punësuarit në sektorin publik. Me atë që, çështje të caktuara të marrëdhënieve së tyre të punës në varësi prej asaj se në cilin grup bëjnë pjesë janë të rregulluara me ligje tjera, të quajtura ligje të vecanta apo ligje materiale (Lex Specialis). Për të punësuarit e Grupit IV, zbatohen dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjit për marrëdhënie pune.


Si ta kuptojmë pasqyrën e llojeve të të punësuarve në sektorin publik? Shtrojini pyetjet në vijim:

- Administratë: A kemi mjaftueshëm nëpunës që mbajnë procedura administrative, që vendosin sipas kërkesave tonë, a kemi mjaftueshëm këshilltarë të ministrave dhe drejtoreve që u jasin analiza profesionale, a kemi mjaftueshëm inspektorë, a kemi mjaftueshëm udhëheqës të seksioneve dhe sektorëve, etj.?
- Mbrojtje, polici dhe zbulim: a kemi mjaftueshëm ushtarë, a kemi mjaftueshëm policë, a kemi mjaftueshëm nëpunës të punësuar në zbulim?;
- Dhënës të shërbimeve publike: a kemi mjaftueshëm mjekë, mësimdhënës dhe profesorë, punëtorë socialë, shoferë të autobusëve dhe trenave, zjarrfikës, solistë në operë dhe aktorë në teatër, shkencëtarë në institucione, etj.;
- Ndihmës nëpunës teknikë: nëse në ministritë, institucionet dhe ndërmarrjet publike punojnë mjaftueshëm njerëz që ndoshta drejtpërdrejtë nuk i shërbejnë qytetarët, por u ndihmojnë nëpunësve të mund ta kryejnë punën e tyre në mënyrë të pandërprerë, si shoferë, mirëmbajtës të parqeve, kuadër hotelierik, pastrues, mirëmbajtës të shtëpive, etj.?

KARAKTERISTIKAT E SEKTORIT PUBLIK NË MAQEDONI

SA TË PUNËSUAR KA NË SEKTORIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË?

Grafika 1: Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Maqedoni në sektorin publik sipas viteve⁵



14

Në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2015 qartë vërehet rritja evidente e të punësuarve në sektorin publik. Në vitet 2007 dhe 2008⁶ punësimi i përgjithshëm sipas të dhënavë të arritshme stagnon, me ç'rast ka rritje evidente për 11,000 të punësuar deri në vitin 2009 dhe rritje të vazhdueshme deri në vitin 2015 kur numri arriti afër 129,600 të punësuar.

Rritja e punësimit të përgjithshëm në sektorin publik për 24,600 të punësuar, apo për 24.4% në lidhje me vitin 2005 e tregon rritjen procentuale të të punësuarve në sektorin publik. Por, nëse marrim parasysh se në këtë periudhë ka shpenzim natyror të të punësuarve të cilët kanë shkuan në pension për shkak të kufirit të pleqërisë apo në bazë tjetër, numri i përgjithshëm i të punësuarve të rinx është më i madh.

⁵ Eurostat, Employment by sex, age and detailed economic activity (from 2008 onwards, NACE Rev. 2 two digit level) - 1 000 (Ifsa_egana2d); Employment by sex, age and detailed economic activity (1992-2008, NACE Rev. 1.1 two digit level) (1 000) (Ifsa_egana2d), I arritshëm në: <http://ec.europa.eu/eurostat/data/database>;

⁶ Për vitet prej vitit 2006 deri në vitin 2008 nuk ka të dhëna për të punësuarit në bibliotekë, muze, arkiv dhe aktivitetet tjera kulturore;

Pasi nuk ekziston e dhënë e një burimi zyrtar për numrin e personave të cilët në këtë periudhë kanë shkuar në pension do të përpinqemi të ofrojmë një projekcion të argumentuar. Të marrim parasysh se kufiri i pleqërisë për të shkuar në pension në vitin 2014 u zhvendos prej 64 vjet për meshkuj dhe 62 vjet për femra, në 67 vjet për meshkuj dhe 65 vjet për femra.⁷ Por, duke pasur parasysh se kjo masë hyri në fuqi në vitin e fundit nga periudha e mbikëqyrjes, relevant e marrim numrin e personave të moshës 60-64 që në vitin 2015 arriti 4.8% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në Maqedoni në atë vit.⁸ Në vitin 2008, ky grup i pleqërisë arriti 3.1% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve.⁹ Të marrim vlerën mesatare se në sektorin publik, personat e moshës prej 60 deri në 64 vjet janë 4% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve. Kjo do të thotë se prej vitit 2005 deri në vitin 2008 në pension prej sektorit publik kanë shkuar 4,200 persona. Nëse me dinamikën e njëjtë është zhvilluar shpenzimi natyror në bazë të shkuarjes në pension, deri në vitin 2012 kanë shkuar edhe 4,200 persona, me çka deri në vitin 2015 kanë shkuar edhe 3,150 persona. Apo gjithsej 11,550 persona në sektorin publik kanë shkuar në pension prej vitit 2005 deri në vitin 2015. Që të vijmë në numrin e përgjithshëm prej 129,000 të punësuar në vitin 2015, kjo do të thotë se prej vitit 2005 deri në vitin 2015 janë punësuar së paku 36,150 persona në sektorin publik.

Maqedonia heq dorë nga trendi në BE 28, në këtë periudhë. Për shembull, në Irlandë prej vitit 2005 deri në vitin 2008 numri i të punësuarve në sektorin publik u rrit në 320,000 me çka deri në vitin 2014 bie në 288,000.¹⁰ Pra, në sytë e krizës ekonomike dhe financiare globale që e përfshiu edhe Evropën pas vitit 2008, në shumë vende të zhvilluara të Evropës u zbatuan masat e kursimit, në mesin e të cilave, edhe zgogëlimi i vëllimit të sektorit publik. Përkundër këtij trendi, në Maqedoni shihet rritja e vazhdueshme e tij.

Madhësia e sektorit publik ndryshon dukshëm ndërmjet vendeve anëtare të OECD-së. Në shtetet nordike, si Danimarka, Norvegjia dhe Suedia, të punësuarit në sektorin publik paraqesin më tepër se 30% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve (për këtë më tepër në kapitujt vijues), kurse vendet në Azi dhe Amerikën Latine që janë anëtare të OECD-së kanë dukshëm sektor publik më të vogël. Në Japoni, sektori publik përfshinë 8% të të punësuarve të përgjithshëm, kurse në Kili dhe Meksikë, diçka më tepër se 10%. Edhe pse në shumë vende anëtare të OECD-së u shënuar rënia e të

15

⁷ Neni 5, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 113/2014);

⁸ T-01.1: Popullsia e aftë për punë sipas aktivitetit ekonomik, gjinisë dhe moshës, 2015, burimi ESHS: http://www.stat.gov.mk/xls_publikaci/2016/2.4.16.02.xls;

⁹ Popullsia e aftë për punë sipas aktivitetit ekonomik, gjinisë dhe moshës, 2008, burimi ESHS: <http://www.stat.gov.mk/Publikaci/2.4.9.12.pdf>;

¹⁰ Boyle R., (2014) Public Sector Trends, State of the Public Service Series, December 2014, fq. 13;


punësuarve në administratën shtetërore, mesatarja e të punësuarve në sektorin publik në nivel të OECD-së në periudhën prej vitit 2009 deri në vitin 2013 është rritur prej 21.1% në 21.3%. Rënia më e madhe e të punësuarve në këtë periudhë u shënua në Belgjikë, Poloni dhe Mbretërinë e Bashkuar. Nga ana tjetër, Danimarka, Norvegjia dhe Sllovenia kanë rritje të të punësuarve në sektorin publik për një pikë përqindje, kurse në Zvicër u shënua rritja prej tri pikë përqindjeve për periudhën e njëjtë.¹¹

Me këtë indikator analizohen aspektet e ndryshme të vëllimit të sektorit publik, por jo edhe cilësia e tij. Çka do të thotë kjo? Nëse të gjithë të punësuarit në sektorin publik janë profesionistë të vërtetë dhe nëse në dispozicion kanë teknikë moderne dhe shërbohen me metodat moderne në punën e tyre, ndonjëherë më pak të punësuar mund të arrijnë më tepër se sa më shumë të punësuar nëse një pjesë e caktuar e tyre nuk punojnë në mënyrë efikase. Për këtë shkak mjaft me rëndësi në sektorin publik është të punësohen njerëz të cilët janë kompetentë dhe të cilët janë të motivuar. Numri i të punësuarve, përmes indikatorëve të shfrytëzuar nuk tregon se si ata janë punësuar. Kjo është lëndë e hulumtimit tjetër dhe për këtë qëllim shfrytëzohen indikatorë tjerë.

16

KU NË SEKTORIN PUBLIK KA MË SHUMË TË PUNËSVAR?

Grafika 2: Numri i të punësuarve në sektorin publik në Maqedoni, sipas sektorëve



¹¹ OECD (2015). Government at a Glance 2015, OECD Publishing, Paris. http://dx.doi.org/10.1787/gov_glance-2015-en, fq. 84;

Numri i përgjithshëm i të punësuarve shënoi rritje të përgjithshme në periudhën e mbikëqyrjes, veprimtaritë e shërbimit shënuan rritjen më të lartë të të punësuarve deri në vitet 2012 dhe 2013, me ç'rast u shënuar rënia e punësimit. Në sferën e arsimit, numri më i lartë i të punësuarve u barazua në vitin 2012 me 42,300 të punësuar me ç'rast deri në vitin 2014 numri bie në 40,200, dhe rritje të lehtë në vitin 2015. Rritje më e vogël u shënuar në shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Numri më i lartë i të punësuarve është matur në vitin 2013, me 37,300 me ç'rast deri në vitin 2014 punësimi në shëndetësi dhe mbrojtjen sociale¹² bie në 35,400 të punësuar dhe stagnon.

Në administratën publike, mbrojtjen dhe veprimtaritë nga sfera e sigurimit të detyrueshëm social¹³ u shënuar rritja konstante e të punësuarve prej 39,300 në vitin 2006, deri në 51,700 të punësuar në vitin 2015. Në lidhje me sektorët tjera, në këto veprimtari janë punësuar pjesa më e madhe e të punësuarve në sektorin publik në Republikën e Maqedonisë, 39.89% në vitin 2015.

Përqindja më e vogël e të punësuarve në sektorin publik janë punësuar në veprimtaritë që jepin mbrojtje sociale pa banim, me 3.70%.

Në lidhje me vendet e Ballkanit Perëndimor, Maqedonia në përqindje ka administratën publike dhe mbrojtjen më të madhe, 39.89% (në Grafikën 3. kryesish përmes administratës publike, mbrojtjes, sigurimit të detyrueshëm social). E dyta për nga madhësia në këtë sektor është Bosnjë e Hercegovina ku administrata dhe mbrojtja përfshijnë 39.71% të gjithsej sektorit publik. Administrata publike dhe mbrojtja paraqesin 34.72% të të punësuarve në sektorin publik në Kroaci, ku pjesa më e madhe e të punësuarve në sektorin publik janë të punësuar në arsim me 36.92% dhe shëndetësi me 24.55%. Përveç në vëllimin e administratës dhe mbrojtjes në lidhje me parametrat tjera të matjes sektori publik në Maqedoni nuk dallohet shumë nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

¹² Vërejtje: [ISIC Rev.4 code Q, UNSTATS], shëndeti dhe veprimtaritë nga punët sociale, ky seksion përfshinë veprimtaritë nga sfera e dhënies së mbrojtjes shëndetësore dhe punët nga sfera e mbrojtjes sociale. Këtu është i përfshirë fushë veprimi i gjerë i veprimtarive, duke filluar nga mbrojtja shëndetësore nga kuadri profesional në spitale dhe institucionet tjera shëndetësore, dhënia e mbrojtjes shëndetësore në kushtet e shtëpisë nga personat me shkallë të caktuar të profesionalizmit dhe aktivitetet nga sfera e mbrojtjes sociale që jepen pa përfshirjen e personave me profesionalizëm në sferën e mbrojtjes shëndetësore.

¹³ Vërejtje: [ISIC Rev.4 code O, UNSTATS], Administrata publike, mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm social: Kategoria i përfshinë veprimtaritë e natyrës administrative, të cilat, sipas rregullit, i kryen administrata publike. Këtu janë përfshirë zbatimi i vendimeve gjyqësore dhe zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore, dhe zbatimi i aktiviteteve që dalin si obligim ligjor, punë profesionale lidhur me përgatitjen e rregullave, tatuimin, mbrojtjen nationale, rendin publik dhe paqen, shërbimet e imigrimit, punët e jashtme dhe zbatimi i politikave qeveritare. Në kategorinë janë përfshirë edhe veprimtaritë nga sfera e sigurimit të detyrueshëm social.

Në lidhje me mesataren evropiane, më shumë të punësuar në administratë, mbrojtje dhe sigurimin e detyrueshëm social me 43.48% të sektorit publik ka Hungaria, kurse më së paku ka Islanda me 16.36%. Mesatarja e vendeve anëtare të BE-së është 29.69%.

Më shumë të punësuar në shëndetësi në lidhje me tërë sektorin publik ka Finnlida me 31.12%, kurse më pak të punësuar në shëndetësi ka Luksemburgu, 15.38% dhe Hungaria, 16.86%.


Pjesëmarrja më e madhe e të punësuarve në sektorin publik të punësuar në arsim në Evropë ka Islanda, 50.91%, kurse më së paku ka Franca, 25.95%. Mesatarja në vendet anëtare të BE-së është 32.57%.



Në lidhje me strukturën e të punësuarve në sektorin publik, Maqedonia është më e ngjashme me mesataren e BE-së në mesataren e të punësuarve në shëndetësi dhe arsim, kurse më shumë lëshon në pjesëmarrjen e të punësuarve në administratë, mbrojtje dhe sigurim të detyrueshëm social. Numri i të punësuarve në këto veprimtari në Maqedoni është për 10.2% më i madh se mesatarja në BE. Mesatarja e të punësuarve në mbrojtjen sociale pa banim në Maqedoni është vetëm 4% të sektorit publik. Mesatarja në BE është 10%.

18

Shikuar nga krahasimi, në aspekt të numrit të të punësuarve, Maqedonia nuk ka sektor publik të madh, por ka ndër sektorët publikë me rritjen më të shpejtë dhe njëren ndër administratat më të mëdha. Atë që mund ta konkludojmë si trend të padëshirueshëm në kushtet e krizës ekonomike është rritja e "administratës klasike", përkatësisht nëpunësve administrativë dhe publikë në lidhje me të punësuarit në shërbimet publike. Nëse rritja e njëjtë ka të bëjë me punësimin e më tepër mjekëve, mësimdhënësve, pedagogëve, defektologëve, punëtorëve socialë, edukatoreve në foshnjore, bibliotekistëve dhe dhënësve tjerë të shërbimeve publike, mendim subjektiv i autorit është se qytetarët do të kenë "vlerë më të madhe" të sektorit publik se sa nga numri i rritur i të punësuarve në administratën shtetërore dhe kuadrin jokrual të punës.


Grafika 3.¹⁴ Struktura e të punësuarve në administratën publike sipas sektorit

¹⁴ Eurostat, i arritshëm në: <http://ec.europa.eu/eurostat/data/database>; Enti i Statistikës [Bosnjë e Hercegovinë] i arritshëm në: http://www.bhas.ba/saopstenja/2016/ZAP_2016M07_001_01_BS.pdf; Enti Shtetëror i Statistikës [për Serbinë] i arritshëm në: <http://webrzs.stat.gov.rs/WebSite/repository/documents/00/02/26/98/zp22092016.pdf>;

* Të dhënat për BeH dhe Serbinë janë pa bibliotekë, arkiv, muze dhe aktivitete tjera kulturore;

ÇFARË ŠEHTË STRUKTURA GJINORE E SEKTORIT PUBLIK? BOTA MASHKULLORE APO FEMËRORE?

Grafika 4.¹⁵ Mesatarja e punësimit të femrave sipas sektorëve



█ ADMINISTRATA PUBLIKE DHE MBROJTJA, SIGURIMI I DETYRUESHËM SOCIAL █ ARSIMI █ SHËNDETËSIA
█ KUJDESİ SOCIAL PA AKOMODIM █ BIBLIOTEKA, ARKIVE, MUZE DHE VEPRIMITARI TJERA KULTURORE

¹⁵ Eurostat, Employment by sex, age and detailed economic activity (from 2008 onwards, NACE Rev. 2 two digit level) - 1 000 (Ifsa_egan22d; I arritshëm në: <http://ec.europa.eu/eurostat/data/database>

Në Maqedoni, pjesëmarrja e femrave në lidhje me meshkujt të punësuar në sektorin publik në Maqedoni, sipas sektorëve është më e madhe në sektorin e mbrojtjes sociale pa banim, ku femrat paraqesin 79% të të punësuarve. Ky sektor paraqet pjesën më të vogël të strukturës së të punësuarve në sektorin publik (sipas parametrave të mbikëqyrjes). Në shëndetësi, 76% të të punësuarve janë femra, në arsim dhe kulturë, 62%, kurse më i vogël është përfaqësimi gjinor i femrave në administratën publike, mbrojtjen dhe sigurimin e detyrueshëm social ku femrat paraqesin vetëm 30% të të punësuarve.

Mesatarja në vendet anëtare të BE-së tregon përfaqësimin të lartë të femrave në administratën publike, mbrojtjen dhe sigurimin e detyrueshëm social me 47% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Në lidhje me parametrat tjera, Maqedonia më pak dallohet në sektorët e arsimit, ku mesatarja e BE-së është 72%. Në shëndetësi, mbrojtje sociale pa banim dhe kulturë, Maqedonia është nën mesataren e BE-së në përfaqësimin e femrave.

Vendi evropian ku femrat janë më pak të përfaqësuara në sektorin publik është Turqia. Përveç në institucionet që japid mbrojtje sociale pa banim ku femrat paraqesin 89% të të punësuarve, në parametrat tjera dukshëm janë nën mesataren e BE-së, kurse më pak janë të përfaqësuara në administratë, siguri dhe sigurim të detyrueshëm social ku paraqesin vetëm 17% të të punësuarve.

21

Shikuar nga krahasimi, sektori publik në Europë dhe Maqedoni është botë femërore.

Nga të dhënat zyrtare të MSHIA-së, kur administrata publike do të shikohet e veçuar nga mbrojtja, në Maqedoni femrat në vitin 2014 kanë qenë thuajse të barabarta me meshkujt në administratën shtetërore (ministratë, inspektoratet, drejtoritë, byrotë, organet e pavarura të drejtorisë dhe organet e vetëqeverisjes lokale), Tabela 1. Në lidhje me përkatësinë etnike femrat janë të përfaqësuara në mënyrë joadekuante se meshkujt në të gjitha bashkësítë etnike, përveç në pjesëtarët e bashkësisë joshumicë shqiptare ku meshkujt janë dyfish më të përfaqësuar se femrat. Në vitin 2015, përfaqësimi i femrave në sektorin publik në Maqedoni sipas të dhënave të MSHIA-së është nën mesatare 45% të të punësuarve në sektorin publik, përveç në armatë, polici dhe Agjencinë e Zbulimit për të cilat institucionet nuk ka të dhëna zyrtare.¹⁶

¹⁶ Nga aspekti metodologjik nuk është e lejuar zbatimi i drejtpërdrejtë i të dhënave nga burimet e ndryshme për shkak të metodologjisë së ndryshme të grumbullimit dhe analizës dhe për këto shkak qe nuk nxjerrim konkluzione konkrete për përfaqësimin e femrave në administratë dhe mbrojtje, edhe pse në shikim të parë nxirret konkluzioni se nuk janë mjaft të përfaqësuara në sferën e mbrojtjes (ARM, polici dhe zbulim).

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ËSHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

Tabela 1.¹⁷ Struktura gjinore e administratës shtetërore sipas sektorëve

	Mosha mesatare		
	Femra	Burra	Mesatare
Veprimtaria/gjinia			
Shëndetësi	47,76	47,86	47,81
Ndërmarrje publike	50,83	50,11	50,47
Kulturë	45,84	46,20	46,02
Pushteti lokal	43,77	45,23	44,50
Arsimi	44,14	46,89	45,52
Organe të pushtetit qendror	42,92	41,75	42,34
Gjyqësori	43,65	41,69	42,67
Punë dhe politikë sociale	46,50	47,49	46,99
Total	46,42	45,91	46,17

¹⁷ Regjistri i të punësuarve në sektorin publik, Ibid, fq. 63;

STRUKTURA GJINORE DHE ETNIKE E ADMINISTRATËS SHTETËRORE NË MAQEDONI

Tabela 2: Pasqyra e strukturës etnike e të punësuarve nëpunës administrativë,
sipas nacionalitetit dhe gjinisë¹

	2010	2011	2012	2013	2014
maqedonas	8.733	10.470	10.166	10.051	10.628
shqiptarë	3.002	3.428	3.942	4.144	4.387
turq	185	239	333	322	370
romë	79	139	222	207	219
vlleħ	94	111	110	117	109
serbë	178	197	224	220	232
bosnjakë	77	94	104	107	113
të tjerë	67	91	90	99	102
nuk janë prononuar	65	52	56	54	52
meshkuj	6.072	7.893	7.932	7.977	8.471
femra	6.480	6.927	7.315	7.344	7.741
maqedonas meshkuj	3.988	5.064	4.670	4.605	4.876
maqedonas femra	4.745	5.406	5.496	5.446	5.752
shqiptarë meshkuj	2.042	2.350	2.653	2.768	2.943
shqiptarë femra	960	1.078	1.289	1.376	1.444
turq meshkuj	105	140	203	195	234
turq femra	80	99	130	127	136
romë meshkuj	45	87	136	125	133
romë femra	34	52	86	82	86
vlleħ meshkuj	47	55	50	54	48
vlleħ femra	47	56	60	63	61
serbë meshkuj	85	89	102	101	104
serbë femra	93	108	122	119	128
bosnjakë meshkuj	37	41	49	49	52
bosnjakë femra	40	53	55	58	61
të tjerë meshkuj	34	48	46	56	57
të tjerë femra	33	43	44	43	45
nuk janë prononuar meshkuj	26	19	23	24	24
nuk janë prononuar femra	39	33	33	30	28
Gjithsej	12.480	14.821	15.247	15.321	16.212

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ËSHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

Deri në vitin 2014, përfaqësimi i grave në administratën shtetërore (ministratë, organet në përbërje, organet e tjera administrative, organizatat administrative) dhe vetëqeverisja lokale është vazhdimisht në rritje, edhe pse janë ende më pak të përfaqësuar se sa burrat, apo përfaqësojnë 47.7% të të nëpunësve administrativ (shtetëror).


Në aspektin e përfaqësimit etnik, më të përfaqësuar ishin nëpunësit e përkatësisë etnike maqedonase me 65.6% të totalit të të punësuarve. Bashkësia e dytë më e përfaqësuar etnike janë të bashkësisë etnike shqiptare të cilët në vitin 2014 kanë qenë 27.1%, të ndjekur nga turqit me 2.3%, serbë 1.4% dhe më pak të përfaqësuar janë vllahët me 0.7%.

Sa i përket strukturës gjinore të bashkësive etnike, të punësuar në administratën shtetërore, gratë me përkatësi etnike maqedonase përbëjnë 54.1% të kësaj bashkësie etnike, pas tyre më të përfaqësuar janë të komunitetit serb dhe vlleh me më shumë se 55%.

Gratë janë më pak të përfaqësuara janë të bashkësisë etnike shqiptare të cilat përbëjnë më pak se 33% të të punësuarve shqiptarë. Gratë e përkatësisë etnike turke përbëjnë 36% të punonjësve të këtij komuniteti, ndërsa gratë rome përfaqësohen me 39%.

ÇFARË DO TË THOTË NUMRI I TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN PUBLIK?

Figura 5¹⁸. Të punësuarit në sektorin publik si përqindje e popullsisë së përgjithshme



25

¹⁸ * Pa bibliotekat, arkivat, muzetë dhe aktivitatet tjetra kulturore;

** Për Bosnjën dhe Hercegovinën të dhënat për veprimtarinë në Kujdesin shëndetësor dhe social 49210;

*** Për Serbinë numri i të punësuarve në Kujdesin shëndetësor dhe social në vitin 2015 ishte 166,000;

**** Për Maqedonia janë përdorur të dhëna nga Entiteti Shtetëror i Statistikës dhe nga Regjistrimi i vitit 2002, numri i përgjithshëm i banorëve 2,069,172.


Përgjigja në pyetjen se sa të punësuar duhet të ketë një shtet në sektorin publik nuk është e thjeshtë, sepse pyetja në vetvete nuk është e thjeshtë.

Pyesni veten si më poshtë, sa shërbime duan qytetarët? A thua qytetarët në zonat me popullsi të dendur duan dhe meritojnë më shumë shërbime se sa qytetarët e zonave më pak të populluara? A thua vendet e zhvilluara dhe rajonet duhet të kenë më shumë shërbime nga ato më pak të zhvilluara? Nevojat e qytetarëve janë të njëjta, dhe të drejtat e garantuara me ligjanë në mënyrë të barabartë duhet të janë në dispozicion për të gjithë qytetarët, pavarësisht se ku ata jetojnë. Për çdo shërbim që “shteti” ua ofron qytetarëve të vet kërkon një numër të caktuar të njerëzve që do ta administrojnë atë. Është e pakontestueshme se vendet e vogla gjithmonë kanë sektor “më të shtrenjtë” publik pasi ato priren të ofrojnë të njëjtin fond të shërbimeve për qytetarët e saj, si dhe vendet e mëdha dhe të zhvilluara. Prandaj, pyetja më mirë të formulohet si në vijim: çfarë numri të sektorit publik mund të përballojë një vend?

Numri i përgjithshëm i të punësuarve, i ndjekur në periudha është një tregues i dobishëm i trendit të rritjes apo zgogëlimit të sektorit publik, por nuk është i vetëm, e as tregues gjithëpërfshirës i justifikimit të madhësisë së vet. Për këtë qëllim përdoren edhe tregues të tjera. Në këtë raport janë përdorë si vijon: madhësia e sektorit publik në raport me popullsinë e përgjithshme, madhësia e sektorit publik në raport me popullsinë në rajone dhe pjesa e shpenzimeve totale të qeverisë në ekonomi e shprehur si një përqindje e prodhimit të brendshëm bruto.

Në raport me popullsinë e përgjithshme në Maqedoni, punonjësit e sektorit publik përbëjnë 6,26%. Kështu, sektori publik në Maqedoni është i ngashëm në vëllim me Serbinë dhe më i madh nga sektori publik në Bosnie dhe Hercegovinë, ndërsa më i vogël se sektori publik në Kroaci dhe Slloveni. Mesatarja e vendeve anëtare të BE-së është 9.96%. Vendet evropiane, ku pjesa e punonjësve në sektorin publik është pak më shumë se 10% janë Gjermania, Finlanda, Irlanda, Malta, Holanda dhe Austria. Sektori më i madh publik në raport me popullsinë e përgjithshme kanë vendet skandinave, Norvegjia me 14,78%, Islanda, Suedia dhe Danimarka me pak më shumë se 13%.

Vendet e zhvilluara me sistem të zhvilluar social kanë një sektor më të madh publik. Vendet më pak të zhvilluara në Evropë kanë sektorë më të vogël publik në raport me popullsinë e përgjithshme dhe Maqedonia nuk është përashtim në këtë trend.

Figura 6¹⁹ Të punësuar në sektorin publik si përqindje e punësimit të përgjithshëm

¹⁹ Eurostat <http://ec.europa.eu/eurostat/data/database> (Sektori publik përfshin: Administrata publike dhe mbrojtja, Sigurimi i detyrueshëm social, Arsimi, Shëndetësia, Puna sociale pa akomodim, bibliotekat, muzetë, arkivat dhe aktivitetë të tjera kulturore; Punësimi total është sipas klasifikimit NACE, (Employment by sex, age and citizenship (1 000) (Ifsa_egan), që gjendet në: <http://ec.europa.eu/eurostat/data/database>

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ŠESTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

Në aspektin e përqindjes së punësimit të përgjithshëm të popullsisë (Figura 6), punonjësit e sektorit publik në Maqedonianë 18.59% e të punësuarve të përgjithshëm.

Në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë sektori publik përbën shumicën e numrit të përgjithshëm të punonjësve ose mbi 24%, ndërsa në Slloveni dhe Kroaci, sektori publik mbulon diç më tepër se 20% e punësimit të përgjithshëm, ndërsa në Bullgari 18.64%. Me këtë, sektori publik në Maqedoni është i ngjashëm me vendet e Ballkanit Perëndimor, që janë anëtarë të BE-së, dhe është më i ulët në raport të mesatares së të gjitha 28 shteteve anëtarë të BE-së. Mesatarja e vendeve anëtarë të BE-së është 23.47%

Pjesë më të madhe në punësimin e përgjithshëm të vendit ka sektori publik në Norvegji me 30%, Franca 29.18%, Belgjika 29.16% dhe Suedia 29.11%.

Më pak të punësuar në sektorin publik në aspektin e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në BE ka Rumania me 14.4%, dhe pas tyre në nivel evropian, në Turqi me 14.95%.

Nga Figura mund të konkludohet se në vendet e zhvilluara dhe vendet me mbrojtje të zhvilluar sociale kanë në përqindje sektor më të madh publik në raport me punësimin e përgjithshëm. Serbia dhe Bosnja, si vende në zhvillim, ata nuk bëjnë pjesë në këtë trend.

28

Figura 7. Punonjësit në sektorin publik si përqindje e punësimit total në OECD 2009 deri 2013²⁰



²⁰ OECD (2015), Ibid. faqe87: Burimi: International Labour Organization (ILO), ILOSTAT (database). Data for Italy are from the National Statistical Institute and the Ministry of Finance. Data for Portugal are from the Ministry of Finance. Data for Korea were provided by national authorities [http://dx.doi.org/10.1787/888933248603]

Figura 8. Të punësuar në sektorin publik si përqindje e fuqisë së përgjithshme punëtore në OECD 2009 deri 2013²¹



Për sa i përket forcës së përgjithshme të punës (të popullsisë aktive), duke përfshirë të papunët, trendi i punësimit në sektorin publik tregon një trend të ngjashëm, si në aspektin e përqindjes së punësimit të përgjithshëm, me disa përashtime. OECD mesatarja e sektorit publik në raport me totalin e forcës punëtore është pak më shumë se 19% nga viti 2009 deri 2013. Një rënje të caktuar në pikë përqindjeje shihet në Spanjë nga 13.2% në 12.7%. Ngjashëm është edhe në Greqi, ku sektori publik në këtë periudhë ka rënë nga 19.9% në 17.5% të fuqisë punëtore të përgjithshëm, por shënon rritje si përqindje e punësimit total nga 22.2% në 22.6%. Rritja e sektorit publik si përqindje në punësimin total, në të dyja vendet nuk është për shkak të rritjes reale të punësimit në sektorin publik, por për shkak të rënies së shpejtë të punësimit të përgjithshëm në ekonomitë e këtyre vendeve për shkak të të cilëve edhe pjesa e sektorit publik në lidhje me të gjithë të punësuarit është rritur.

²¹ OECD (2015), Ibid. faqe87: Burimi: International Labour Organization (ILO), ILOSTAT (database). Data for Italy are from the National Statistical Institute and the Ministry of Finance. Data for Portugal are from the Ministry of Finance. Data for Korea were provided by national authorities [http://dx.doi.org/10.1787/888933248615]

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ŠESTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

Tabela 3²² Përbledhje e të punësuarve në administratën komunale në rajonet e Maqedonisë në raport me tregues krahasues për popullsinë aktive, norma shkalla e punësimit dhe prodhimi i brendshëm bruto

2015	Numri i të punësuarve në administratën komunale	POPULLSIA AKTIVE (Fuqia punëtore) ISCED 0-5 dhe më shumë	SHKALA E PUNËSIMIT	PBV [3] (Për kokë banori) ²
R.Maqedonisë	5.825	954.925	42,1	100,0
Rajoni i Vardarit	402	76.030	45,8	107,5
Raj.Lindor	549	92.088	51,6	95,7
Raj. Jugperëndimor	842	99.449	36,2	74,1
Raj.Juglindor	542	96.442	56,9	119,2
Raj. Pellagonisë	529	124.486	52,2	98,7
Raj.Pologut	773	122.934	33,2	46,0
Raj.Verilindor	401	76.495	30,6	58,3
Raj.Shkupit	1.787	266.997	40,4	143,6

30


Duke pasur parasysh se administrata komunale është një numër i vogël i popullsisë së përgjithshme aktive në këto rajone, është vështirë të hartohej një pasqyrë piktoreske. Në raport të popullsisë aktive në rajonet planore mund të vërehet një trend i ngashëm, që në rajonet me një popullsi më të madhe aktive ka edhe administratë më të madhe komunale (duke përashtuar rajonin e Pellagonisë, i cili edhe pse për diferençë të vogël tregon administratë më të vogël nga rajonet e tjera në raport me numrin e popullsisë aktive). Për këtë arsy, ne mund të konkludojmë se me përashtim të rajonit të Pellagonisë, numri i të punësuarve në administratën komunale (duke përashtuar ndërmarrjet publike dhe institucionet komunale) është më i lartë në rajonet me popullsi më aktive.

Krahasuar përsëri me normën e punësimit dhe PBV-në për kokë banori, rajoni i Shkupit, Pellagonisë, ai Juglindor dhe ai Lindor kanë administrata më të vogla se sa rajoni i Vardarit, ai Jugperëndimor, ai i Pollogut dhe Verilindor, edhe pse kanë një normë më të lartë të punësimit dhe PBV më të lartë për kokë banori.


²² Burimi: Enti shtetëror për statistikë; Popullsia aktive: e përbëjnë të punësuarit dhe të papunët (fuqia punëtore); Shkalla e punësimit: si pjesëmarrje e punonjësve në popullsinë me aftësi pune, të moshës 15 vjeç e më lart; Popullsi me aftësi pune janë të gjithë personat e moshës 15 deri në 79 vjet;

Kushtimisht thënë, në raport me PBV-në për kokë banori dhe shkalla e punësimit, administratë më të madhe komunale ka në rajonin e Pollogut, ku vërehet shkallë më e ulët e PBV-së për kokë banori dhe vetëm 33% shkallë e punësimit, dhe si rajon janë të tretët sipas madhësisë së administratës komunale..

Figura 9. Paga mesatare në Maqedoni për periudhën 2005 - 2015



SA FITOHET NË SEKTORIN PUBLIK?

Figura 10²³ Lartësia e pagave në Maqedoni për vitin 2015 përfusha të ndryshme sektoriale

Pagat mesatare brenda sektorit publik ndryshojnë edhe pse nga viti 2005 deri në vitin 2015 ka pasur një rritje të përgjithshme të pagave në Maqedoni në të gjithë sektorët. Rritja e treguar në grafikun 9 reflekton rritje në sasinë nominale të pagave mesatare dhe jo edhe shportën e konsumatorit. Rritja më e pagave është regjistruar në periudhën 2008 deri në 2009, pas së cilës pagat rriten shumë pak.

²³ MAKSTAT, Paga mesatare bruto për punonjës, për veprimtari në sektorë, sipas NKD Rev. 2, sipas muajve. Në dispozicion në: <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/?rid=36829ddd-fd1c-4a5f-9cf9-021856ec0d79>

Në raport me pagën mesatare në Maqedoni në administratën publike, mbrojtje dhe sigurimi i detyrueshëm social paguhen mesatarisht paga më të larta edhe pse jo në mënyrë të konsiderueshme. Më vete sipas veprimtarive, paga më e ulët mesatare për veprimtarie administrative dhe shërbime paguhet edhe në industrinë e përpunimit. Pagat më të larta mesatare në veprimtaritë financiare dhe të sigurimit, TIK dhe furnizimin me energjensë, ku pagat janë më të larta se veprimtaritë e tjera, si dhe nga vetë mesatarja në Maqedoni.

Në këtë kuptim, pagat në administratën publike, mbrojtje, sigurinë e detyrueshme sociale dhe shëndetësore janë mesatarisht më të larta se sa veprimtaritë tjetra në sektorin publik²⁴, si dhe nga shumica e veprimtarive në sektorin privat, por janë larg nga pagat më të larta mesatare në Maqedoni.

Duhet të theksohet se rritja e pagave nuk do të thotë përmirësim të standardeve të jetesës.

Për shembull, në vitin 2014, në përputhje me kornizën e re ligjore, punonjësit administrativ kanë të drejtë për një shtesë të pagës për shkak të përshtatjes me tregun e punës.²⁵ Kjo do të thotë se rritja e pagave mund të jetë për shkak të intencës së Qeverisë për të ndjekur rritjen e çmimeve në vend, rritjen e pagave mesatare dhe në përgjithësi në rritjen e kostos së jetesës dhe kështu ti ngre pagat në administratë. Rritja e pagave mund të jetë për shkak të masave të tjera të Qeverisë, por jo domosdoshmërisht do të thotë se në mënyrë efektive ua përmirëson standartet e jetesës punonjësve. Nëse merret parasysh norma mesatare e inflacionit gjatë një periudhe prej 10 vitesh, vlera nominale e pagës mesatare me kalimin e kohës e humbet fuqinë reale blerëse, për shkak të së cilës edhe një rritje e caktuar në pagat nominale jo domosdoshmërisht do të thotë rritje e fuqisë së vërtetë blerëse.

33

Tabela 4²⁶ : Inflacioni (mesatarja, në një bazë kumulative, në%) / 2

2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
0,5	3,2	2,3	8,3	-0,8	1,6	3,9	3,3	2,8	-0,3	-0,3

²⁴ Kontributet e personave të zgjedhur ose të funksionarëve ndryshojnë nga mesatarja e personave me punësim të rregullt apo të nëpunësve administrativë dhe ofruesve të shërbimeve publike;

²⁵ Neni 89. paragrafi 1 dhe alineja 2 dhe Neni 91 Ligjit për Nëpunës Administrativ (Gazeta Zyrare e RM-së nr.27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 5/2016);


²⁶ Inflacioni (baza mesatare kumulative, në%) 2: Treguesit kryesorë ekonomikë për Republikën e Maqedonisë, BPRM 2017 [http://nbrm.mk/WBStorage/Files/Statistika_Osnovni_makroek_indikatori_mak.xlsx];

Sektori publik jo domosdoshmërish duhet të jetë një zgjedhje karriere me të ardhura të larta (me përashtim të vendeve të punës më të larta)²⁷ dhe përqendrimi më i madh i pozitave menaxhueze gjendet në administratë. Megjithatë me punën në institucion publik vijnë përfitime të caktuara në drejtim të punës mesatare në sektorin privat. Disa nga këto përfitime janë disa siguri dhe të ardhura të besueshme në kushte krize, sigurim shëndetësor i sigurt, pension i caktuar dhe qasje më të lehtë në kredi për shkak se punësimi në administratën publike është ende tërheqës.

SA NA KUSHTON NEVE SEKTORI PUBLIK?

Figura 11.²⁸ Shpenzimet e përgjithshme qeveritare si përqindje në PBB

34



²⁷ Për shembull: Në vitin 2014, nga gjithsej 16. 212 nëpunës shtetëror, 180 janë sekretarë, 956 këshilltarë shtetëror, 1872 udhëheqës sektorësh, 1313 ndihmës/udhëheqës të sektorëve dhe 5605 udhëheqës të njësive; D.m.th 9887 persona kanë pasur të ardhura më të mëdha se 30.000 denarë;


²⁸ Burimi: Economy Watch 2015: Total expenditure consists of total expense and the net acquisition of nonfinancial assets;

Treguesi që më së shpeshti është përdorur për madhësinë e përgjithshme të sektorit publik është shpenzimi qeveritar i shprehur si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto. Treguesi reflekton shpenzimet totale të qeverisë dhe blerjet e aseteve dhe është përdorur për të marrë një pasqyrë të përgjithshme në pjesëmarrjen e fondeve buxhetore të cilat i ka në dispozicion qeveria (në kuptimin më të gjërë) në ekonominë e një vendi.

Në vitin 2015 pjesa e shpenzimeve totale të qeverisë në Maqedoni ka qenë 33% e PBB-së, që është dukshëm më pak se që ka Serbia 44.7% dhe Bosnie-Hercegovina 46.8%, Kroacia 47.5%, si dhe Sllovenia 44.1% dhe është më afër pjesëmarrjes së shpenzimeve totale të qeverisë të PBB-së së Bullgarisë me 38.7% dhe Rumanisë me 34.3%. Kështu, Maqedonia është nën mesataren e shpenzimeve totale të qeverisë si pjesë e PBB-së në rajon.

Pjesëmarrje më të madhe në shpenzimet e përgjithshme qeveritare në PBB, nga vendet e Evropës në vitin 2015 kanë pasur Finlanda me 58.4%, Franca 56.8%, Danimarka dhe Belgjika me pak më shumë se 53%.

Figura 12.²⁹ Numri i të punësuarve në sektorin publik në raport me PBB-në
dhe Borxhin e jashtëm bruto



Edhe pse në krahasim shpenzimet totale të qeverisë si përqindje e PBB-së nuk ishin aq të mëdha në raport me vendet e rajonit dhe të Evropës në vitin 2015, megjithatë, në qoftë se i marrim në konsideratë kushtet lokale në vend, rritja e numrit të të punësuarve në sektorin publik nuk e ndjek zhvillimin e ekonomisë. Domethënë, nëse marrim si një parametër normën e rritjes reale të PBB-së nga viti 2006 deri në vitin 2015, ne shohim se ka një rënje

²⁹ Burimi i të dhënave për numrin e të punësuarve në sektorin publik - Eurostat baza e të dhënave në të cilën mungojnë të dhënat për vitin 2008, 2009 dhe 2010 për shkak të dallimit në klasifikimin kombëtar të veprimtarive/Burim i të dhënave mbi PBB-në dhe borxhit të jashtëm bruto: Treguesit ekonomik bazë për Republikën e Maqedonisë, BPRM 2017

[http://nbrm.mk/WBStorage/Files/Statistika_Osnovni_makroek_indikatori_mak.xlsx; Tabela 4. [Pjesëmarrja e PBB-së (%)]]

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ŠEHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

të ndjeshme prej 5.5% në vitin 2008, në -0.4% në vitin 2009, pas së cilës luhatet edhe në vitin 2015 ku arrin në 3.8%, përsëri më e ulët se norma e rritjes reale në vitin 2008.

Borxhi i jashtëm bruto në këtë periudhë është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga 45.7% të PBB-së në vitin 2006 deri në 69.4% të PBB-së në vitin 2015.

Gjatë gjithë kësaj periudhe numri i të punësuarve në sektorin publik është vazhdimesht në rritje dhe siç konstatuan në Figuren 1, nga viti 2006 deri në vitin 2015 është rritur me 24.4% në krahasim me vitin 2016, ose të paktën për 36.150 njerëz. Nuk ka tregues ekonomik që e justifikon këtë prirje.

Tabela 4.³⁰ Pjesëmarrja në PBB (%)³¹

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyruar; arsimi; veprimtaritë kujdesit shëndetësor dhe social	14,2	15,3	14,8	14,3	14,9	12,8	12,4	12,2
Buxheti/Totali i të hyrave (në milionë)	128.739	153.215	143.334	148.404	156.750	147.957	158.243	163.280
Buxheti / shpenzimet totale (në milionë)	134.279	164.797	153.796	159.992	169.198	165.652	176.514	181.777
Pagat dhe përfitimet e pagave si % e shpenzimeve (në milionë)	23.204	25.154	22.844	23.299	22.693	23.136	23.682	24.451
Pagat dhe përfitimet e paguara si % e shpenzimeve	17,3	15,3	14,9	14,6	13,4	14,0	13,4	13,5

Shpenzimet e administratës publike, mbrojtjes, sigurisë së detyrueshëm sociale, arsimit, kujdesit social dhe shëndetësor në Maqedoni të shprehura si përqindje e PBB-së, kulmin e vet e arritën në vitin 2009, kur kanë përbërë 15.3% të PBB-së dhe që atëherë deri në vitin 2015 kanë shënuar një rënje të vazhdueshme.

.....

³⁰

³¹ Burimi: Prodhimi i brendshëm bruto sipas metodës së prodhimit, sipas NKD Rev. 2, sipas viteve (nga përllogaritjet tremujore të PBB-së);

Edhe pse nga Grafiku 1 vërehet një rritje e qëndrueshme e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin publik nga viti 2006 deri në vitin 2015 dhe nga Grafiku 2 vërehet se një pjesë e rritjes shkon në kuriz të shëndetësisë, kujdesit social dhe arsimit, dhe në krahasim me administratën publike, mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm social janë veprimtaritë që nga viti 2009 gradualisht kishin një pjesëmarrje më të vogël në PBB-në.


Sa para shpenzohen në sektorin publik, edhe pse përdoret si një tregues i dimensioneve të përgjithshme të sektorit publik, nuk na jep përgjigje në pyetjen se si janë shpenzuar këto fonde dhe për çfarë investohen. Cilësia e shërbimit në sektorin publik kërkon hulumtim të veçantë dhe për ta hulumtuar si duhet përdoren tregueset të tjera.

Është e qartë se buxheti nga viti në vit rritet, me çfarë pjesëmarrja në përqindje i shpenzimeve të administratës publike, mbrojtjes, sigurimit të detyrueshëm social, arsimit, shëndetësisë dhe kujdesit social zvogëlohet, ndërsa në terma nominal ai është më i lartë. E njëjtë gjë është e qartë nëse ne i shikojmë shpenzimet për pagat dhe kontributet e pagave të parapara në buxhet. Nga viti 2009 deri në vitin 2015 shpenzimet e pagave dhe kontributeve për paga në shumën nominale rritet që do të thotë se më shumë para jepen për paga dhe kontributet e pagave. Për shkak se buxheti në përqindje është më i madh nga rritja e pagave, pjesëmarrja e pagave në shpenzimet totale të buxhetit është më i ulët.

37

CILAT JANË PERCEPTIMET E CILËSISË SË ADMINISTRATËS NË RAPORT ME RAJONIN?

Grafiku 13: Efikasiteti i qeverisë³²



³² Burim për treguesit: Kaufmann D., A. Kraay, and M. Mastruzzi (2010), The Worldwide Governance Indicators: Methodology and Analytical Issues The Worldwide Governance Indicators are available at: www.govindicators.org

Ky indeks reflekton perceptimet e të anketuarve në lidhje me cilësinë e shërbimeve publike, cilësia e administratës publike dhe shkalla e pavarësisë së administratës nga presionet politike, cilësia apo aftësia për të formuluar dhe zbatuar politikat publike dhe besueshmëria e qeverisë në angazhimet për ti kryer ato politika.

Rezultatet janë të shprehura në përqindje pikësh në shkallë nga 0 si vlera më e ulët deri në 100. Në grafikun e shfaqura janë marrë vlera nga viti 2005, 2010 dhe 2015 për vendet e rajonit.

Ajo që vërehet në vendet nga shembulli është se vërehet një rritje e qëndrueshme deri në vitin 2010, pas së cilës në Kroaci, Greqi dhe Slloveni deri në vitin 2015 ka një rënje të lehtë në renditje edhe pse si vende të BE-së janë mbi 65. Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor pavarësisht rritjes së vazhdueshme ende tregojnë rezultate të dobëta dhe asnjëra nga vendet nuk arrin ta kalojë pragu e 60 për qind të shkallës.

Rezultate më të ulëta ka arritur Bosnja dhe Hercegovina, e cila për dhjetë vite ka arritur nga 26.83 pikë përqindje të rritet në 33.68. Më shumë përmirësim në drejtim të këtij indeksi tregon Shqipëria e cila nga 31.22 pikë përqindje në vitin 2005 për dhjetë vjet është rritur në 54.81 pikë përqindje.

38

Maqedonia nga 45.85 pikë përqindje në vitin 2005 u rrit në 58.65 në vitin 2015, me çfarë edhe pse tregon përmirësim në perceptimin e efektivitetit të qeverisë, nuk është nivel i kënaqshëm në raport me vendet fqinje që janë shtete anëtare të BE-së nga rajoni i Ballkanit, ndërsa rezultate të ngjashme në periudhën e matjes tregon edhe Serbia.

Shënim: The Worldwide Governance Indicators (WGI) are a research dataset summarizing the views on the quality of governance provided by a large number of enterprise, citizen and expert survey respondents in industrial and developing countries. These data are gathered from a number of survey institutes, think tanks, non-governmental organizations, international organizations, and private sector firms. The WGI do not reflect the official views of the World Bank, its Executive Directors, or the countries they represent. The WGI are not used by the World Bank Group to allocate resources.

Grafiku 14: Parandalimi i korruptionit

Ky indeks reflekton perceptimet e të anketuarve për nivelin deri te i cili autorizimet publike përdoren për të realizuar interesa private, duke përfshirë forma të vogla dhe të mëdha të korruptionit, si dhe “kapjen” e shtetit nga ana e elitave dhe interesave private.

Të vetmet vende ku janë vërejtur përmirësimë të qëndrueshme në perceptimin e aftësisë së qeverisë për të luftuar korruptionin në periudhën e matjes janë Shqipëria dhe Serbia, edhe pse edhe me vlerat më të larta në vitin 2015 nga 40.38 pikë përqindje për Shqipërinë dhe 50.96 për Serbinë janë larg nga të kënaqshme. Rejting më të ulët sa i përket këtij indeksi tregon Shqipëria. Përmirësim në krahasim me vitin 2010 për 6 pikë përqindje, nga 57.62 në 63.46 ka në Kroaci, që është një nga vendet më mirë të renditura në shembullin, pas Sllovenisë e cila nga viti 2005 deri në vitin 2015 ka rënë rejtingu për 3 pikë përqindje, duke rënë nga 79 në 76.44.

Vendet tjera nga rajoni të përfshira në shembullin tregojnë një rënë në rejtingun në periudhën e matjes. Rënia më e madhe shënohet në Maqedoni, nga 53.08 në vitin 2010, për pesë vjet bie përgati 10 pikë përqindje në 42.36, nivel më i ulët për pesë pikë përqindje në krahasim me vitin 2005. Ky tregues tregon një rënë të konsiderueshme të besimit në qeveri për t'u marrë me korruptionin. Në vitin 2016, për herë të parë në Raportin (e progresit) e Komisionit Evropian për Maqedoninë janë theksuar shqetësimë në lidhje me kapjen e shtetit nga ana e aktorëve kryesorë në vend.³³


³³ The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report“, Commission Staff Working Document, Brussels 9.11.2016, SWD(2016) 362 final : ... raising concerns about state capture of institutions and key sectors of society.” Fq. 8;

RAPORT NGA NDJEKJA NR. 1

SA ŠEHTË I MADH DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)?

Analizë e karakteristikave të sektorit publik në RM

Grafiku 15: Pjesëmarrja në proces të vendim-marrjes, liria e shprehjes



40

Ky indeks reflekton perceptimet e të anketuarve për nivelin deri te i cili në shtet u është lejuar qytetarëve të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve publike, në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në pushtet dhe liria e shprehjes, lirinë e organizimit dhe lirinë e mediave .

Ajo që është e dukshme është se te vendet më të zhvilluara në rajon ka rënje në lidhje me këtë tregues. Në Greqi në krahasim me vitin 2005 pikë përqindjet 81.25 deri në vitin 2015 janë ulur me rreth 13 pikë përqindje, apo 68.47 pikë përqindje. Në Slloveni rënja ishte pak më e ulët, nga 83.65 pikë përqindje në 2005 në 74.38 në vitin 2015. Të vetmet vende të cilat kanë shënuar përmirësim në vazhdimësi (edhe pse larg nga e mjaftueshmja) janë Shqipëria dhe Serbia. Shqipëria për 10 vjet ka arritur ta rrissë këtë indeks për një pikë përqindje dhe në vitin 2015 ishte 53.69 pikë përqindje.

Rejting më të ulët sa i përket këtij indeksi tregon Maqedonia, nga 53.08 pikë përqindje në vitin 2010 bie në pozitën e fundit në këtë tabelë në rajon, me 42.36 pikë përqindje në vitin 2015 që tregon një besim të zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme në lirinë e shprehjes, lirinë e organizimit, liria e medias dhe mundësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre në qeveri.



**QENDRA PËR
MENAXHIM ME
NDRYSHIME**

Qendra për menaxhim me ndryshime (QMNC)
Rr. "Rajko Zhinzifov" 44/1, 1000 Shkup
Tel. fax: +389(0)2 6092-216
E-mail adresë: info@cup.org.mk
www.cup.org.mk